



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1.1, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Ligji nr. 03/L-229, (Gazeta zyrtare nr. 88, dt. 25.11.2010) si dhe neni 4 dhe 7A, paragrafi 2 i Plotësim Ndryshimit të Ligjit 04/L-226 Komisioni i Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me **dt. 21.11.2017** nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.03/2017
MBI PËRJASHTIMET GRUPORE TË
MARRËVESHJEVE VERTIKALE TË NDËRMARRËSVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Ky Udhëzim Administrativ përcakton kushtet që marrëveshjet vertikale ndërmjet ndërmarrësve duhet ti përmbajnë, si dhe kushtet të cilat këto marrëveshje nuk duhet ti përmbajnë në mënyrë që të jenë të përjashtuara në grup nga marrëveshjet e ndaluara sipas nenit 4, paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Përkufizimet

Neni 2

Në këtë Udhëzim Administrativ termet e mëposhtme kanë këto kuptime

- a) *Marrëveshje vertikale*- është kontratë, ndonjë dispozitë e kontratës, marrëveshjet gojore ose me shkrim, praktikat e bashkërenduara që rezultojnë në marrëveshje të tilla, vendimet nga ndërmarrësit ose shoqatat e ndërmarrësve, kushtet e përgjithshme dhe aktet tjera të ndërmarrësve, të cilat janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e kontratës, të lidhura ndërmjet palëve që nuk veprojnë në të njëjtin nivel të prodhimit ose të shpërndarjes, e të cilave iu parashtröhën kushtet me të cilat pjesëmarrësit në marrëveshje mund të blejnë, shesin apo rishesin mallra dhe / ose shërbime të caktuara;

- b) *kufizimi vertikal*- është kufizimi i konkurrencës i përcaktuar në marrëveshjet e ndaluara (vertikale) që përfshinë neni 4, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e Konkurrencës ligji bazik;
- c) *Ndërmarrëje* - është shprehje e përcaktuar në nenin 2, paragrafi 1.7 të Ligjit nr. 04/L-226 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- d) *Ndërmarrësi nën kontrollin e ndërmarrësit tjetër ose ndërmarrësit e lidhur të cilët konsiderohen si një subject ekonomik janë ndërmarrësit që:*
 - 1) kanë më tepër se gjysmën e pjesëve apo të akcioneve
 - 2) kanë më tepër se gjysmën e të drejtës së votës
 - 3) kanë të drejtën e caktimit të më shumë se gjysmës së anëtarëve drejtues ose mbikqyrës
 - 4) në ndonjë mënyrë tjetër kanë të drejtë në udhëheqjen e ndërmarrëjes

Ndërmarrësi nga pikat e lartëshenuara konsiderohën si një subjekt ekonomik

- e) *produkt* - do të thotë mallra dhe / ose shërbime;
- f) *produkt zëvendësues (substitut)*- është produkt i cili edhe pse ka karakteristikat e tij të veçanta, çmim ose mënyrë të përdorimit, respektivisht konsum të zakonshëm mund të zëvendësohet me një produkt tjetër (të rëndësishme), dhe në këtë mënyrë të kënaq nevojën ekuivalente të klientit dhe / ose konsumatorit;
- g) *konkurrent*- është emër i përbashkët për konkurrentët aktuale apo të mundshëm (potencial)
- h) *konkurrent aktual*- është ndërmarrësi që vepron në të njëjtin treg përkatës;
- i) *konkurrent i mundshëm*- është ndërmarrësi i cili do të mund, nëse nuk qëndron një ose më shumë marrëveshje vertikale në tregun përkatës, në rastet e ngritjeve të vogla, por të përhershme të çmimeve, në afate të shkurta implementon investime shtesë dhe hyn në at treg përkatës apo ka siguruar shpenzimet e nevojshme të kalimit nga një treg tjetër përkatës në at treg përkatës;
- j) *blerës* - është një ndërmarrës i cili blen një produkt nga furnizuesi për të instaluar në produkt të ri të cilin e prodhon, ose blen nga furnizuesi me qëllim të rishitjes së tij një blerësi tjetër apo shitjen tek përdoruesi i fundit respektivisht konsumatori,
- k) *blerës i tërthortë*- është ai ndërmarrës i cili nuk është një pjesëmarrës i marrëveshjes vertikale por blenë mallra ose shërbime që janë objekt i marrëveshjes, nga blerësi i cili është pjesëmarrës në marrëveshje vertikale,
- l) *konsumatorë* - është personi fizik i cili blen respektivisht përdorë ose në një mënyrë mund të përdorë, produktin përkatës;
- m) *tregu relevant/përkatës* - fushën e tregtisë për të cilën konkurrenca është kufizuar në një zonë të caktuar gjeografike, duke përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet e zëvendësueshme për të cilat konsumatorët mund të drejtohen në afat sa më të shkurtër, në rast se kufizimi apo abuzimi rezulton në ngritjen e çmimit;
- n) *Ligj* – është Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229(Ligji bazik)

Marrëveshjet vertikale në të cilat implementohet përjashtimi gruporë

Neni 3

1. Përjashtimi grupor zbatohet për marrëveshjet vertikale sipas *Nenit 6, paragrafi 1, të Ligjit*, të cilat përmbajnë disa kufizime vertikale, në veçanti në:
 - a. marrëveshjet për shpërndarjen ekskluzive,
 - b. marrëveshjet për shpërndarjes selektive,
 - c. marrëveshjet për blerje ekskluzive,
 - d. marrëveshjet për (Furnizim) ekskluziv,
 - e. Marrëveshjet për franshizë (ekskluzivitet), përveç marrëveshjeve mbi franshizën industriale (teknologjike) të cilat i dedikohen prodhimit të produkteve ose procesit teknologjik në prodhimin e këtyre produkteve.
 - f. Marrëveshjet që përmbajnë dispozita me të cilat blerësit i ofrojnë ose i japin në përdorim të drejtën e pronësisë intelektuale, me kusht që këto dispozita nuk përbëjnë objektin parësor të marrëveshjeve të tilla, dhe se janë të lidhura drejtpërdrejt me përdorimin, shitjen dhe / ose rishitjen e produkteve të kontratës nga ana e blerësve të drejtpërdrejtë ose të terthortë.
2. Marrëveshja mbi shpërndarjen ekskluzive nga paragrafin 1, pika a) i këtij neni, është marrëveshje vertikale, me të cilën shitësi detyrohet të shes produktet nga marrëveshja vetëm një shpërndarësi të zgjedhur në një zonë të caktuar ose një grupi të caktuar të blerësve, të cilët i janë ndarë vetëm ati shpërndarësi.
3. Marrëveshja mbi shpërndarjen selektive nga paragrafi 1, pika b) i këtij neni, është marrëveshje vertikale me të cilën furnizuesi drejt ose në mënyrë të tërthort detyrohet për ti shitur produktet të cilat janë objekt i kontratës, vetëm shpërndarësve të përzgjedhur në bazë të kriterëve transparente, kriterëve të veçanta ndërsa shpërndarësit detyrohen se nuk do ti shesin ato produkte shpërndarësve të paautorizuar.
4. Marrëveshja mbi blerjen ekskluzive nga paragrafi 1, pika c) i këtij neni, është marrëveshje vertikale me të cilën blerësi drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthort detyrohet për të blerë produkte të cilat janë objekt i kontratës, vetëm nga furnizuesit e caktuar.
5. marrëveshja mbi furnizimin ekskluziv nga paragrafit 1, pika d) i këtij neni, është marrëveshje vertikale me të cilën furnizuesi drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthort detyrohet për ti shitur produktet të cilat janë objekt i kontratës, vetëm një blerësi në territorin e Kosovës për qëllimet e përdorimit specifik apo për rishitje.
6. Marrëveshja mbi franshizën (ekskluzivitetin) nga paragrafi 1, pika e) i këtij neni, është marrëveshje vertikale me të cilën një ndërmarrës (dhënsi i franchizës) i jep tjetërit (marrësit të franshizës), në shkëmbim të kompensimit financiar drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë, të drejtën për të shfrytëzuar franshizën, dmth. Paketën e të drejtës së pronësisë industriale ose intelektuale me qëllim të shitjes së disa lloje të produkteve. Paketa e pronësisë industriale ose intelektuale ka të bëjë me emrin dhe shenjen mbrojtëse, shenjen tregtare, përvojën dhe njohuritë e veçanta (Know-how), modelet, dizajnet, të drejtat e autorit, njohjet e

teknologjisë ose patentet të cilat do të përdoren për rishitjen e produkteve, e të cilat janë objekt i marrëveshjes, përdoruesve të fundit.

Marrëveshjet vertikale në të cilat nuk zbatohet përjashtimi gruporë

Neni 4

Mbi bazën e këtij Udhëzimi administrativ nuk mund të përjashtohen nga ndalimi i përgjithshëm nga neni 6, paragrafi 1 i Ligjit:

- a) Marrëveshjet vertikale që nuk përputhen me këtë Udhëzim,
- b) Marrëveshjet vertikale në të cilat ekskluzivisht aplikohen dispozita tjera mbi përjashtimet grupore nga Ligji ose Udhëzimet tjera për përjashtimet grupore.

II. KUSHTET QË MARRËVESHJET VERTIKALE DUHET TI PËRMBAJNË

Pjesa e tregut

Neni 5

1. Përjashtimet grupore nga neni 3 i këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen, me kusht që pjesa e tregut e furnizuesit në tregun përkatës, në të cilin shet produkte të cilat janë objekt i marrëveshjes nuk është më e madhe se 30%, dhe se pjesa e tregut të blerësit në tregun përkatës në të cilën blen produkte të cilat janë objekt i marrëveshjes, nuk është më e madhe se 30%.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, përjashtimi grupor sipas nenit 3 të këtij Udhëzimi Administrativ do të zbatohet për marrëveshjet vertikale të lidhura mes disa pjesëmarrësve, në të cilat një ndërmarrës që është palë e asaj marrëveshjeje blen produktin, e i cili është objekt nga marrëveshja e pjesëmarrësit tjetër dhe at produkt ia shet pjesëmarrësit të tretë të marrëveshjes, me kusht që pjesa e tregut të ndërmarrësve pjesëmarrës në marrëveshje, i cili blenë e shet produkte që janë objekt i marrëveshjes, dhe në tregun përkatës në të cilën ai blen produktin, dhe në tregun përkatës në të cilin shet produktin nuk është më e madhe se 30%.

Llogaritja e pjesës së tregut

Neni 6

1. Pjesa e tregut të furnizuesit në tregun përkatës, në kuptim të nenit 5, paragrafi 1, të këtij Udhëzimi Administrativ llogaritet në bazë të të dhënave nga viti i kaluar kalendarik mbi pjesën e furnizuesit në vlerën totale të të gjitha mallrave të shitura që janë objekt i marrëveshjes.

2. Pjesa e tregut të blerësit në tregun përkatës, në kuptim të nenit 5, paragrafi 1, të këtij Udhëzimi Administrativ llogaritet në bazë të të dhënave nga viti i kaluar kalendarik mbi pjesën e blerësit në vlerën totale të të gjitha produkteve të blera që janë objekt i marrëveshjes.
3. Pjesa e tregut e referuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, mbledhet shuma e vlerës totale të produkteve të blera dhe / ose të shitura të ndërmarrësve të ndërlidhur të cilët ata , në vitin paraprak kalendarik, kanë realizuar nga tregu i produkteve të cilat janë objekt i marrëveshjes.
4. Shumat e referuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni do të zvoglohen nga shumat e taksave dhe tatimeve.
5. Në rast se pjesa e furnizuesit dhe / ose blerësit në vlerën totale prej mallrave të shitura dhe / ose të blera e të cilat janë objekt i produktit nga ky nen nuk është i njohur, për përcaktimin e pjesëve të tregut (aksioneve) të tyre në treg mund të përdoren dhe të dhëna të tjera tregtare që disponon, duke përfshirë vëllimin e shitjeve apo blerjeve në treg, përveq nëse ndërmarrësi nuk ka kryer aktivitet në tregun përkatës në vitin financiar i cili i ka parapri marrëveshjes së lidhur.
6. Nëse pjesa e tregut të ndërmarrësit në momentin e lidhjes së marrëveshjes nuk është më e madhe se 30%, por më pas ngritet mbi atë nivel, jo më shumë se 35%, përjashtimi grupor do të zbatohet për një periudhë prej dy vjetësh kalendarike rresht pas vitit në të cilin për herë të parë ka rritur sasinë e tregut mbi 30%.
7. Nëse pjesa e tregut në momentin e lidhjes së marrëveshjes nuk është më tepër se 30% por më pas ngrihet mbi 35%, përjashtimi gruporë do të vazhdojë të aplikohet në kohëzgjatjen prej një viti kalendarik i cili pason vitin në të cilin pjesa e tregut është për herë të parë tejkaluar mbi 35%.
8. Përjashtimi grupor në kuptim të paragrafit 7 dhe 8 të këtij neni nuk mund të kombinohen në mënyrë që të kalojnë periudhën e përjashtimit grupor për më shumë se Dy vite kalendarike.
9. Pjesa e tregut të ndërmarrësve të lidhur sipas paragrafit 3 të këtij neni, do të ndahen në mënyrë të barabartë në mesin e atyre ndërmarrësve.

Totali i të hyrave vjetore për marrëveshje të caktuara vertikale

Neni 7

1. Përjashtimet grupore sipas këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen edhe për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet shoqatave të interesit të ndërmarrësve dhe anëtarëve të tyre, si dhe në mes shoqatave të interesit të ndërmarrësve dhe furnizuesve të tyre, me kusht që të gjithë anëtarët e tyre të jenë shitës me pakicë në treg, dhe se asnjë anëtar individual i shoqatës së interesit të ndërmarrësve, së bashku me ndërmarrësit e lidhur, nuk realizojnë të hyrat e përgjithshme vjetore prej më shumë **se 500,000.00 euro**.
2. Përjashtimet grupore sipas këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen edhe për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet ndërmarrësve që janë konkurrentë me kusht që marrëveshja nuk garanton të drejta dhe detyrime të barabarta, në rastet kur:

- a. Furnizuesi njëkohësisht është prodhues dhe shperndares i produkteve, ndërsa blerësi shpërndan ato produkte, por nuk i prodhon ato produkte apo zëvendësuesit e tyre, respektivisht nuk është konkurrent në nivelin e prodhimit,
- b. Furnizuesi ofruet i shërbimeve në disa nivele të tregtisë, ndërsa blerësi shet mallra dhe / ose shërbime në veprimtarinë e shitjes me pakicë, por nuk është i furnizuesit në nivelin e tregtisë ku blen shërbime të cilat janë lëndë e marrëveshjes,
- c. Në qoftë se blerësi ka një qarkullim total vjetor jo më shumë se **500,000.00 euro**.

Llogaritja e të hyrave të përgjithshme vjetore

Neni 8

1. Në bazë të nenit 7 të këtij Udhëzim Administrativ, të të hyrat e përgjithshme vjetore llogariten si të hyra të përgjithshme vjetore të ndërmarrësve të marra gjatë vitit financiar që i paraprin lidhjes së marrëveshjes dhe me të cilin u shtohen të hyrat e përgjithshme të qarkullimit vjetor ndërmarrësve të ndërlidhur.
2. Të hyrat e përgjithshme nga shitja e produkteve ndërmjet pjesëmarrësve në marrëveshje vertikale dhe dhe me te ndërmarrësit e ndërlidhur dhe ndërmjet vet pjesëmarrësve të ndërlidhur nuk merren parasysh në llogaritjen e të hyrave të përgjithshme vjetore të nga paragrafin 1 i këtij neni.
3. Të hyrat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni do të zbriten nga shumat e taksave dhe tatimeve.
4. Përjashtimet grupore nga nenit 7 i këtij Udhëzimi Administrativ do të vazhdojnë të zbatohen edhe në qoftë se gjatë një periudhe prej Dy vitesh financiare radhazi pragu I të hyrave vjetore të qarkullimit është tejkaluar nga më shumë se 10%.

III. KUFIZIMET, OSE KUSHTET TË CILAT MARRËVESHJET VERTIKALE NUK GUXOJN Ë TI PËRMBAJNË

Kufizimet e rënda të konkurrencës së tregut

Neni 9

1. Përjashtimi grupor nuk mund të zbatohet për marrëveshjet vertikale të cilat, direkt ose indirekt, vetëm apo së bashku me faktorë tjerë, nën kontrollin e palëvenë marrëveshje, përmbajnë kufizimet vertikale të cilat konsiderohen kufizime të rënda të konkurrencës së tregut dhe të cilat kanë për qëllim:
 - a. Kufizimin e së derjtës blerësit për të përcaktuar çmimin e shitjes së produktit, pa cenuar të drejtën e furnizuesit që të përcaktoj çmimin maksimal të shitjes ose rekomandon çmimin e shitjes, me kusht që të mos jetë fjala për çmime fiks ose minimale të shitjes, e që është rezultat i presionit ekzekutues ose stimulues të ndonjëres palë kontraktuese,

- b. kufizimin e zonës në të cilën blerësi pjesëmarrës në marrëveshje mund të shesë produktet e të cilat janë object i marrëveshjes, ose të kufizojë shitjen e produkteve të kontraktuara për një grup të veçantë të konsumatorëve,
 - c. Kufizimin anëtarëve Brenda sistemit shpërndarjes selektive që veprojnë në tregtinë me pakicë, aktive ose passive të shitjeve të produkteve përdoruesve të fundit, duke mos e përjashtuar mundësinë për të ia ndaluar një anëtari Brenda shpërndarjes selektive që të veproj jashtë vendit të hapësirës së autorizuar të punës,
 - d. Kufizimin e furnizimeve mesvete në mes të shpërndarësve brenda një sistemi shpërndarjeje selektive, duke përfshirë kufizimin në mes të shpërndarësve që nuk operojnë në të njëjtin nivel të tregtisë,
 - e. Kufizimin furnizuesve të pjesëve, pjesë të cilat i shitën blerësit për t'i instaluar në produktin e ri, nga shitja e këtyre pjesëve, si pjesë reserve përdoruesve të fundit ose riparuesve si dhe ofruesve tjerë të shërbimeve, të cilët blerësi nuk ka autorizuar për riparim ose servisim të produkteve të tija.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1, pika b) të këtij neni, nuk konsiderohet ndalim i kufizimeve vertikale kufizimet që kanë për qëllim:
 - a. Kufizimin e blerësit të drejtpërdrejtë shitjen aktive në territorin e ndarë ekskluziv ose grupit blerës ekskluziv të rezervuar për vetë furnizuesin, respektivisht në zone ose blersve të cilve furnizuesi iu ka ndarë blerësve tjerë, me kusht që këto kufizime të imponuara nga furnizuesit, nuk e parandalojnë rishitjen nga blerësit indirekte,
 - b. Kufizimin blerësit, i cili operon në nivel me shumicë, shitjet aktive dhe pasive për përdoruesit e fundit,
 - c. Kufizimin anëtarëve brenda sistemit të shpërndarjes selektive të shitjeve aktive dhe pasive të shpërndarësit të paautorizuar të produkteve,
 - d. Kufizimin e së drejtes së blerësit në shitjen aktive ose passive të blerjes së pjesëve me të cilat furnizohet nga furnizuesi me qëllim të instalimit të këtyre pjesëve në produkte të reja, shfrytëzuesve të fundit të cilët ato pjesë do të përdorin për prodhimin e produkteve që janë zëvendësuese për produktet e prodhuara nga furnizuesi.
 3. Shitjet aktive në kuptimin e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, nënkupton kërkesën aktive dhe afrimin blerësve ose një grupi të caktuar të blerësve të cilët janë të vendosur vetëm në territorin e furnizuesit tjetër, lidhjen e kontratave individuale dhe marrëja e masave për afrimin e produkteve atyre blerësve, si dhe krijimin e degëve, magazinimit apo organizimit e rrjeteve shpërndarëse dhe reklamat në territorin e një shpërndarësi tjetër. Me qasje aktive konsiderohet vizita e konsumatorit, dërgimi I postës blerësve, duke përfshirë edhe postën elektronike, reklamat në media dhe informacione të tjera publike të destinuara ekskluzivisht për këtë grup të blerësve apo grupit të blerësve në territorin ekskluziv të shpërndarësit tjetër.
 4. Shitjet pasive në kuptimin e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, nënkupton përgjigjanë kërkesën e blerësit individual, duke përfshirë shpërndarjen e produkteve blerësve të tillë, me rekomandim që i përgjigja e tillë nuk guxon të jetë pasojë e veprimeve të shitjes aktive. Me shitjen pasive konsiderohen edhe reklamat e përgjithshme ose promovimi në media apo në

internet që arrin jasht territorit ekskluziv të ndokujtë ose të ndonjë gruoi të caktuar blerësish, e që është rezultat i zhvillimit të teknologjisë, respektivisht lehtësimin në qasje, e që konsiderohet mënyrë e arsyeshme e afrimit atyre blerësve ose grupeve të blerësve.

Detyrimet e ndaluara në marrëveshjet vertikale

Neni 10

1. Përjashtimet grupore nuk mund të zbatohen për detyrimet e mëposhtme të përfshira në marrëveshjet vertikale:
 - a. Detyrimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta të konkurrencës kohëzgjatja e të cilave është e pakufizuar ose tejkalon pesë vjet respektivisht të cilat përseriten në mënyrë të heshtur dhe zgjasin më shumë se pesë vjet, sepse konsiderohet se kanë qenë të kontraktuara për një periudhë të pacaktuar,
 - b. Detyrimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta për të cilat blerësi, pas përfundimit të marrëveshjes, nuk guxonë të prodhojë, blejë, shes apo rishes produktet që janë lëndë e marrëveshjes,
 - c. Detyrimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta të imponuara anëtarëve selektiv të sistemit shpërndarës që të mos e shesin produktin me markën e ndonjerit nga furnizuesit konkurrent të tregut.
2. Detyrimet e mos konkurrimit, në kuptim të paragrafit 1, pika a) të këtij neni, nënkupton çdo detyrim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për të cilin blerësi nuk mund të prodhojë, shesë ose të rishesë zëvendësues që konkurrojnë me produktet që janë object I marrëveshjes, ose çdo detyrim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë blerësit për të blerë nga furnizuesi ose nga një ndërmarrës tjetër, të udhëzuar nga furnizuesi më shumë se 80% nga sasia e përgjithshme e prodhimit. Kjo përqindje llogaritet në bazë të vlerës së blerjes së produkteve dhe zëvendësuesve të tyre në tregun përkatës që blerësi ka realizuar në vitin paraprak financiar.
3. Pavarësisht nga paragrafi 1, pika a) i këtij neni, detyrimi i mos konkurrueshmërisë që zgjat më shumë se pesë vjet nuk konsiderohet kufizim vertikal i ndaluar kur blerësi shet produkte të cilat janë lëndë e marrëveshjes në hapësirat e punës ose në tokën pronarë I së cilës është furnizuesi, ose nga furnizuesi me qira nga palët e treta e cilz nuk ka lidhshmëri me blerësin, me kusht që kohëzgjatja e detyrimit të moskonkurrimit nuk e tejkalon periudhën të cilën blerësi i shfrytizon hapësirat e punës ose tokën e furnizuesit.
4. Pavarësisht nga paragrafi 1, pika b) të këtij neni nuk konsiderohet kufizim i ndaluar vertikal nëse kohëzgjatja e detyrimit të blerësit është e kufizuar në një afat prej një viti pas përfundimit të marrëveshjes, por:
 - a. Detyrimet kanë të bëjnë me produktet të cilat konkurrojnë me produktet të cilat janë lëndë e kontratës (produktet zëvendësuese)
 - b. Detyrimi është i kufizuar në ambientet e punës nga e cila edhe toka nga e cila blerësi ka operuar gjatë periudhës së kontratës, dhe
 - c. Detyrimi është i domosdoshëm për të mbrojtur njohuritë specifike dhe përvojat (knoë-hoë) të cilin furnizuesi ia kalon blerësit, me kusht që këto njohuri specifike dhe

përvoja (know-how) janë të rëndësishme dhe të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes.

5. Kohëzgjatja e detyrimit të blerësit e cila është e kufizuar në një periudhë prej një viti pas përfundimit të marrëveshjes, siç është përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni nuk përjashton mundësinë e jo kufizimit kohorë të perdorimit të kufizuar, transferimit ose zbulimeve të njohurive dhe përvojave (know-how) të veçantë, por vetëm me kusht që njohuritë specifike dhe përvojat (know-how) për të gjithë kohën që janë të mbrojtura me kontratë pas përfundimit të marrëveshjes, **të mbeten sekret**, të rëndësishëm dhe të njohura.
6. Njohuritë specifike dhe përvojat (know-how) në kuptimin e paragrafit 4, pika c) dhe paragrafit 5 të këtij neni konsiderohen paketat e informacioneve praktike të pa-patentuara që rezultojnë nga përvoja dhe testimi nga ana e furnizuesit, e cila është paketë e fshehtë, I rëndësishëm dhe i njohur. Secret apo e fshehtë ka kuptimin se njohuritë specifike dhe përvojë (know-how), nuk janë të njohura botërisht, ose lehtësisht të arritshme. I rëndësishëm, do të thotë se njohuritë specifike dhe përvoja (know-how) përfshijnë informacione të rëndësishme dhe të dobishme për blerësit, që të munda ti shfrytzoj ti shesë dhe ti rishesë produktet të cilat janë objekt i marrëveshjes. Të njohura (veçanta), ka kuptimin që njohuria dhe përvoja e veçantë (know-how) është e përshkruar në mënyrë mjaft të plotë dhe në mënyrë të kuptueshme, për të bërë të mundur të verifikohet se i plotëson kriteret e sekretit dhe rëndësisë.

IV. REVOKIMI NGA PËRJASHTIMIT GRUPOR

Kushtet për revokimin e përjashtimit grupor

Neni 11

(1) Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti) mund, sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 5 të Ligjit dhe - 7A, të Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, të iniciojë procedurën për vlerësimin e një marrëveshjeje të caktuar horizontale, megjithëse kjo marrëveshje i plotëson kushtet për përjashtim grupor sipas këtij Udhezimi Administrativ, në rastet kur efektet e asaj marrëveshjeje, në mënyrë të pavarur ose në mënyrë kumulative me marrëveshje të ngjashme në tregun përkatës, nuk përmbushin në mënyrë kumulative gjatë kohëzgjatjes së tyre kushtet për përjashtim nga neni 5 i Ligjit dhe - 7A të Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226.

(2) Autoriteti mund të fillojë vlerësimin e marrëveshjes vertikale në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, veçanërisht në rastet:

a) kur hyrja në tregun përkatës apo konkurrenca e tregut, ndjeshëm kufizohet nga efekti kumulativ i marrëveshjeve vertikale të cilat përmbajnë kufizime të ngjashme vertikale,

b) kur rrjetet paralele të marrëveshjeve vertikale me kufizime të ngjashme vertikale së bashku mbulojnë më shumë se 50% të tregut përkatës.

(3) Në rast se Autoriteti gjat procedurës së vlerësimit të ndonjë marrëveshjen nga paragrafi 1 i këtij neni, konstaton se marrëveshja ka efekte të cilat janë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenit 6 dhe 7 të Ligjit dhe të këtij Udhëzimi Administrativ, me vendim do ti heqë përjashtimin grupor për atë marrëveshje.

Barra e provës mbi përmbushjen e kushteve për përjashtim

Neni 12

(1) Për marrëveshjet vertikale që kualifikohen për përjashtim grupor sipas këtij Udhëzimi Administrativ, në parim, duhet të përmbushën kushtet e nenit 6 dhe 7 të ligjit, përveç në rastin e nenit 11 të këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Përjashtimisht, për marrëveshje vertikale të cilat nuk kualifikohen për përjashtim gruporë sipas këtij Udhëzimi Administrativ, pjesëmarrësit në këto marrëveshjeve duhet vetë të vlerësojnë nëse marrëveshjet e tyre i plotëson kushtet, pavarësisht nga kushtet për përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve sipas nenit 6 dhe 7 të Ligjit.

(3) Nëse Autoriteti fillon procedurën për konstatimin e marrëveshjes së ndaluar sipas paragrafit 2 të këtij neni, barrën e provës për përmbushjen e kushteve për përjashtim sipas nenit 6 dhe 7 të Ligjit, në atë procedurë, do ta marrin ndërmarrësit pjesëmarrë në atë marrëveshje vertikale.

Zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ edhe në marrëveshjet vertikale në sektorin e shpërndarjes dhe servisimit e automjeteve.

Neni 13

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet edhe për marrëveshjet vertikale mbi shitjen e pjesëve rezerv për automjete motorike si dhe marrëveshjet vertikale mbi ofrimin e riparimeve dhe mirëmbajtjen e automjeteve, të cilat janë të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, me kusht që këto marrëveshje të përmbushin kërkesat specifike për përjashtimet grupore, të atyre marrëveshjeve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ mbi përjashtimin grupor të marrëveshjeve për shpërndarjen dhe servisimin e automjeteve.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Dispozitat kalimtare

Hasja në vështirësi gjatë aplikimit të dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ apo mungesa e dispozitave për marrjen e vendimit përfundimtar, duhet të aplikohen dispozitat e ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të konkurrencës.

Neni 14

Ndryshimi dhe plotësimi i udhëzimit administrativ

Ndryshimin dhe plotësimin e këtij Udhëzimi Administrativ mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

Neni 15

Marrëveshjet vertikale për përjashtimet grupore ndërmjet ndërmarrësve duhet të harmonizohen plotësisht me dispozitat e kësaj udhëzimi administrativ.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

KOMISIONI I
AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

(_____)
Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)
Ahmet Krasniqi
Zëvendëskryetar

(_____)
Fatime Haziri
Anëtare

(_____)
Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)
Shaqir Morina
Anëtar